



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

Korçë, më datë 19/10/2021

Proces-verbal nr. 1

Bazuar në ligjin Nr 139/ 2015, neni 3, pika “dh”, në datën 27 shtator - 05 tetor 2021 në kuadrin e procesit të “Buxhetimit me Pjesëmarrje”, për të diskutuar lidhur me kërkesa dhe shqetësime të kryetarëve dhe banorëve të fshatrave u zhvilluan takime të njëpasnjëshme me kryetarët e Njësive Administrative të Bashkisë Korçë si dhe me banorë të çdo njësie.

Pjesë e panelit të diskutimit ishin z. Sotiraq Filo Kryetar Bashkia Korçë, Kletion Kita Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Thanas Tona Zv. Kryetar Bashkia Korçë, Soniel Prifti Drejtri i Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Korçë, Ilir Dinellari Drejtori i Ndërmarrjes së Shërbimeve Publike.

Fjalën e mori i pari z. Sotiraq Filo, i cili listoi disa nga investimet e mëdha të realizuara por edhe në proces në Njësiti Administrative. Mes tyre përmendi projektet: ndërtimi i ujësjellsave të rinj në disa fshatra të Bashkisë Korçë, ndërhyrjet e njëpasnjëshme në rrugët e parcelave në të gjithë fshatrat e Bashkisë Korçë, ndriçimin publik, rehabilitimin e rrjetit të brendshëm rrugor në fshatrat e Bashkisë Korçë etj. Në vazhdim ai foli edhe për rëndësinë e marrjes së mendimeve të kryetarëve dhe banorëve të fshatrave për investimet gjatë vitit të ardhshëm në mënyrë që t’ju jepet prioritet atyre ndërhyrjeve që vetë ata i shohin më emergjente.

Pasi u njohën me shpjegimet përkatëse për “Buxhetimin me Pjesëmarrje”, dhe mundësinë që ata kanë për të zgjedhur vetë ato ndërhyrje që Bashkia e Korçës duhet t’i shohë me përparësi, kryepleqtë patën mundësinë për të parashtruar kërkesat e tyre dhe për të vendosur prioritetet sa i takon fokusit të investimeve të Bashkisë Korçë për vitin 2022. Kërkesat e tyre u mbajtën shënim paralelisht dhe të detajuara sipas grafikut të takimeve të zhvilluara më poshtë.

Takimet e zhvilluara:

27 shtator Njësia Administrative Bulgarec
28 shtator Njësia Administrative Drenovë
29 shtator Njësia Administrative Mollaj
01 tetor Njësia Administrative Voskop
04 tetor Njësia Administrative Voskopojë dhe Lekas
05 tetor Njësia Administrative Vithkuq

Bazuar në kërkesat e ngritura nga kryetarët dhe banorët e fshatrave u listuan nevojat e tyre si më poshtë:

BULGAREC

- **Fshati Belorta:** Mungesa e ujit të pijshëm dhe ujit për vaditjen e prodhimeve në parcela
- **Fshati Barç:** Riparimi i rrugës kryesore të fshatit, zgjidhja e problemeve me ujin e pijshëm
- **Fshati Çiflig:** Meremetimi i shkollës, asfaltimi i rrugëve të fshatit
- **Fshati Dishnicë:** Zgjidhja e problemit të kanalizimeve të ujrave të zeza, ndërhyrje tek fusha e futbollit në fshat
- **Fshati Bulgarec:** Asfaltim i rrugës së vjetër të fshatit, ndërhyrje në ambjentet çlodhëse dhe argëtuese pranë shkollës

Në fshatin Belorta (Xxxx) Uji i pijshëm është një nga domosdoshmëritë kryesore të fshatit tonë. Por edhe uji që na shërben për vaditje është një tjetër shqetësim për ne. Kemi nevojë gjithashtu për ndërhyrje riparuese për rrugët e brendëshme të fshatit.

Në fshatin Barç (Xxxx) Në fshatin tonë jemi të kënaqur për investimin në ujësjellësin e ri të fshatit që për ne ka qënë problem. Na duhet ndërhyrje në rrugën kryesore të fshatit që është e amortizuar. Faleminderit!

Në fshatin Çiflig (Xxxxx) Kërkojmë një ndërhyrje riparuese tek çatia e shkollës së fshatit. Po ashtu edhe rruga e fshatit ka nevojë për ndërhyrje si dhe kanalizimi i ujrave të zeza. Faleminderit që na bëni pjesë të këtyre takimeve, shpresojmë që me mbështetjen tuaj të vazhdueshme do t'i zgjidhim problemet që kemi.

Në fshatin Dishnicë (Xxxxx) Në fshatin tonë kemi nevojë për ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza. Gjithashtu riparimet e rrugëve të brendëshme të fshatit janë shumë të nevojshme, sidomos tek vendi që ne e quajmë “rruga e çobankave”, do të ishte mirë të

vendosej sinjalistikë rrugore për normalizimin e qarkullimit të mjeteve në zonat që ka më shumë lëvizje.

Në fshatin Bulgarec (Xxxxxx) Investimet e bëra në këtë fshat kanë qënë brenda pritshmërive tona dhe ne jemi të kënaqur. Prioritet për në vazhdim është infrastruktura rrugore, si në rrugën e vjetër ashtu edhe në rrugën e re që kërkon sistemim me trotuar dhe asfaltim, shtimi i ndriçuesve publikë dhe ndërhyrje në rrjetin e kanalizimeve. Nëse është mundësia, ndërtimi i një këndi lojrash për fëmijët është shumë i nevojshëm.

Në fshatin Kuç të Zi (Xxxxxx) Një nga problemet tona më shqetësuese është mungesa e ujit të pijshëm. Po ashtu edhe shtrimi i rrugës kryesore të fshatit pasi është e amortizuar. Kanali i Vendtrokut ka nevojë për mbajtëse anësore.

Në fshatin Neviçisht (Xxxxxx) Jemi të kënaqur me ato investime që janë bërë në fshatin tonë. Është e kuptueshme që në çdo fshat ka shumë punë për të bërë dhe nuk është e lehtë që çdo gjë të zgjidhet shumë shpejt. Kërkesa jonë është riparimi i rrugëve të parcelave që kanë nevojë për çakullim për të na lehtësuar punën me prodhimet bujqësore.

DRENOVË

- **Fshati Boboshticë:** Shtimi i ndriçuesve publikë në fshat dhe riparimi i rrugëve të brendëshme që kanë mbetur pa u asfaltuar
- **Fshati Turan:** Rehabilitim i rrjetit të ujrave të zeza të fshatit dhe zgjidhja e ujit për vaditjen e parcelave, riparim i rrugëve të brendëshme të fshatit me asfalt
- **Fshati Ravonik:** Shtimi i ndriçuesve publikë në fshat, plotësimi i rrjetit të kanalizimeve dhe asfaltim në rrugën hyrëse të fshatit
- **Fshati Drenovë:** Ndërhyrje rehabilituese në rrugët e fshatit
- **Fshati Qatrom:** Pastrimi i kanaleve vaditëse dhe anësore të fshatit, asfaltim i rrugës
- **Fshati Mborje:** Rrethimi dhe zgjerim i hapësirës në varrezat e fshatit, riparimi i rrugëve me kalldrëm dhe asfalt
- **Fshati Dardhë:** Zgjidhja e problemit të inerteve dhe rrjeti i kanalizimeve të ujrave të zeza

Në fshatin Boboshticë (Xxxxxx) Jemi të kënaqur përsa i përket investimeve të kryera në fshatin tonë nga ana e bashkisë. Duke kërkuar mirëkuptimin tuaj, mendojmë se është e nevojshme një ndërhyrjeje për asfaltimin e disa rrugëve në fshat. Zgjidhja e problemeve me ujitjen dhe vaditjen, si dhe shtimi i të paktën 15 ndriçuesve publikë.

Në fshatin Turan (Xxxxxxx) kërkojmë të bëhet sistemimi i rrjetit të ujrave të zeza në fshat por edhe zgjidhjen e problemit të ujit për vaditje pasi mungojnë kanalet vaditëse. Shtimi i

ambjenteve çlodhëse në qendër të fshtit dhe ambjent për moshën e tretë. Riparimi i disa rrugëve në qendër të fshatit dhe vendosja e parmakëve tek ura në hyrje të fshatit.

Në fshatin Ravonik (Xxxxxx) Vendosja e ndriçuesve publikë është një kërkesë e jona.

Gjithashtu kërkojmë ndërhyrje tek sistemi i kanalizimeve në dy rrugë të fshatit dhe kanalet vaditëse në parcela. Gjithashtu rruga hyrëse e fshatit ka nevojë për riparim urgjent.

Në fshatin Drenovë (Xxxxxx) Jemi falenderues për investimet që janë bërë në fshatin tonë.

Megjithatë kemi disa kërkesa të cilat do të doja ti ndanim dhe ti zgjidhnim së bashku. Zgjerimi i rrugëve të fshtit mendojmë se është i nevojshëm për qarkullimin normal të mjetëve. Rruga nga varrezat deri tek kisha e Shën Kollit ka nevojë për asfaltim. Do të ishim të kënaqur nëse do të shtohet një ambjent argëtues për fëmijët pranë shkollës së fshatit.

Në fshatin Qatrom (Xxxxxx) Jemi të kënaqur me disa ndërhyrje që janë bërë në fshatin tonë, por kërkojmë pastrimin e kanaleve që janë bllokuar nga mbeturinat. Ndërtimi i një këndi sportiv në fshat është një kërkesë e vazhdueshme e të rinjve për të kaluar kohë në mënyrë aktive, besoj se do zgjidhet sa më parë, si dhe asfaltimi i rrugëve të brendëshme të fshatit. Problem ndjejmë kur vjen sezoni i vaditjes pasi nuk kemi ujë të bollshëm në toka.

Në fshatin Mborje (Xxxxxx) Rrethimi me mur në varrezat e reja dhe shtim i hapësirës së tyre janë të nevojshme. Kërkojmë shtrimin me kalldrëm të dy rrugëve tek lagjia e krishterë, dhe tek lagjia e egjiptianëve mendojmë se është i nevojshëm asfaltim i rrugëve. Faleminderit!

Në fshatin Dardhë (Xxxxxx) Veç investimeve të bashkisë, problem për ne mbetet gjetja e gjuhës së përbashkët me njëri – tjetrin për zgjidhjen e problemit të ujit që ne e kemi me vetëmenaxhim. Vendosja e një table për orjentimin e trafikut pasi kamionat e tonazhit të rëndë po dëmtojnë rrugët e fshatit. Kemi probleme me ujërat e zeza dhe një ndërhyrje tjetër tek zyra e pleqësisë së fshatit.

MOLLAJ

- **Fshati Floq:** Zgjidhje e problemeve me taksat dhe tarifatat vendore, sistemim i rrugës së kishës
- **Fshati Kamenicë:** Sistemimi i urave të fshatit, riparim i ndriçimit publik, ndërhyrje në dy rrugë të fshatit
- **Fshati Dvoran:** Pastrimi i shtratit të lumit
- **Fshati Pulahë:** Sistemimi i urës, probleme me ujin e pijshëm
- **Fshati Ujë-Bardhë:** Sistemimi i depotëve të ujit, ndërhyrje në rrugët e parcelave, pastrim i kanaleve

Në fshatin Ujëbardhë (Xxxxxx) Ne kemi të nevojshme vënien në funksion të depotëve të ujit, pasi linja nuk është e përshtatshme dhe nuk mban ngarkesën. Duhet të rregullohen varrezat e fshatit pasi muri ndarës është vendosur keq mes dy varreve. Gjithashtu kemi nevojë për një urë lidhëse në të dy anët e kanalit të Gjançit tek zona që njihet si “arat” e hidrocentralit si dhe betonizim të kanalit vaditës.

Në fshatin Floq (Xxxxxx) Së pari ne jemi falenderues për të gjitha investimet që janë bërë në fshatin tonë, por punët janë të shumta dhe mbetet akoma për të bërë. Shqetësimi ynë

lidhet me çështjen e taksave dhe tarifave vendore. Unë jetoj në një shtëpi me prindërit por jam i ndarë në trung dhe jam kryefamiljar. Përse duhet të paguaj taksa kur unë nuk kam një banesë më vete dhe taksat i paguan babai që jeton në një shtëpi me mua. Kërkojmë një zgjidhje nga ana juaj për këtë problem. Një problem tjetër është rruga e kishës në fshatin tonë, e cila ka nevojë për asfaltim.

Në fshatin Kamenicë (Xxxxx) Punën në fushë, këtë sezon e kemi pasur më të lehtë për shkak se rrugët e parcelave janë të gjitha të sistemuara. Problem për ne mbeten shtrimi i dy rrugëve në fshat, dhe sistemimi i bordurave në lumin që kalon përmes fshatit. Kemi nevojë për shtimin e koshave të mbeturinave dhe ndriçues publikë.

Në fshatin Dvoran (Xxxxx): Problemi jonë shqetësues është se kush po administron rezervuarin e Gjançit pasi kemi vënë re se po abuzohet me menaxhimin e tij. Lumi i Dvoranit është mbushur sërish me inerte prandaj duhen bërë tre kaskada me gacione teli.

Në fshatin Pulahë (Xxxxx) Uji i pijshëm ngelet problemi kryesor për fshatin tonë. Gjithashtu është e nevojshme edhe sistemimi i një ure që ndodhet tek baxhoja në fshat. Faleminderit!

Në fshatin Ujë-Bardhë (Xxxxx): Në fshatin tonë kemi probleme me depon e ujit. Gjithashtu, duhet të sistemohet rrjedha e përroit përgjatë një rruge në fshat, si dhe pastrimi i kanaleve.

VOSKOP

- **Fshati Voskop:** uji i pijshëm, ujërat e zeza, riparim i rrugëve në parcela
- **Fshati Dërsnik:** Ndërhyrje në rrugën Pulahë-Dërsnik, sistemim i rrugëve në parcela, asfaltim i rrugëve brenda fshatit
- **Fshati Polenë:** Riparim i sistemit vaditës, pastrim i kanaleve vaditëse
- **Fshati Goskovë:** Zgjerim i rrugëve të fshatit, sistemim i rrugës me stabilizant
- **Fshati Damjanec:** Sistemim i rrugëve të fshatit, ndërhyrje tek rruga e varrezave
- **Fshati Vinçan:** Zgjidhje e problemit të vaditjes, sistemim i ujrave të zeza

Në fshatin Voskop (Xxxxx) Problemi kryesor për banorët e fshatit tonë mbetet uji i pijshëm, ndërsa kemi nevojë edhe për sistemimin e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të zeza. Shqetësim tjetër mbetet izolimi i transformatorëve pasi janë jashtë kabinave elektrike, që u bënë të reja, dhe rrezikojnë jetën e banorëve. Vaditja e tokave bujqësore vijon të ngelet problem, në kohën e thatë nuk vjen shumë ujë, prandaj kërkojmë të bëhet ndonjë rezervuar për ujtitje. Për të rinjtë e fshatit mbetet një kërkesë sistemimi i fushës së sportit. Faleminderit që na bëtë pjesë të takimit duke dëgjuar kërkesat tona.

Në fshati Dërsnik (Xxxxx) Jemi shumë falenderues për investimet e bëra në fshatin tonë, veçanërisht për ujësjellësin që ka qënë një problem për ne. Kemi nevojë për një ndërhyrje të vogël tek rrugët e parcelave për ti sistemuar ato. Gjithashtu kërkojmë asfaltimin e rrugës lidhëse mes Polenës dhe Dërsnikut, si dhe sistemimin e rrugëve të brendëshme të fshatit. Kërkesë e jona

është një ndërhyrje mirëmbajtëse tek çezmat historike që ne kemi në fshat dhe një ambjent çlodhës kryesisht për moshën e tretë.

Në fshatin Polene (Xxxxx) Rrugët e parcelave falë ndërhyrjeve që ka bërë bashkia kanë qënë në gjendje mjaft të mirë dhe na kanë ndihmuar mjaft në punët e bujqësisë. E shohim të nevojshme vendosjen e një saraçineske tek uji që shërben për vaditje, dhe betonizimi i përroit të fshatit. Sistemimi i rrugës nga përroi deri tek lumi është i nevojshëm për ne, përmes një trotuari për këmbësorët.

Në fshatin Goskovë Lart: (Xxxxx) Rrugët e fshatit Goskovë lart janë me një kalim, prandaj kërkojmë shtimin e tombinove për të bërë të mundur zgjerimin e tyre. Investimi i nisur tek fusha e sportit është lënë përgjysëm. Prandaj kërkojmë që të përfundojë për t'u dhënë të rinjve një ambjent argëtimi.

Në fshatin Goskovë Lart: (Xxxxx) Kemi nevojë për çakullimin e një rruge që lidh dy rrugët kryesore pasi kalimi është i vështirë. Me investimin e ujësjellësit të ri në fshatin tonë, kërkojmë vendosjen e matësave për t'u furnizuar të gjithë me ujë të pijshëm.

Në fshatin Damjanec: (Xxxxx) Brenda fshatit një pjesë e rrugëve janë të pashtuara prandaj kërkojmë ndërhyrjen për sistemimine tyre. Problem është rruga që të çon tek varrezat e fshatit, e cila duhet sistemuar sa më parë. Vendosja e tombinove në tokat bujqësore sipër fshatit është e nevojshme për të na lehtësuar punën e përditëshme.

Në fshatin Vinçan: (Xxxxx) Investimet e bëra në fshatin tonë janë përgjithësisht të mira dhe ne jemi falenderues, por kemi ende probleme të pazgjidhura me rrjetin e ujrave të zeza dhe sistemimin e vaditjes të cilat shpresojmë që të zgjidhen sa më shpejt.

VOSKOPOJË DHE LEKAS

- **Fshati Voskopojë:** Ndërhyrje në rrugët e kalldrërta, sistemim i rrugëve të parcelave
- **Fshati Shipskë:** Ndërhyrje tek Rruga e Shipskës, riparimi i sistemit të ujrave të zeza tek kisha e fshatit
- **Fshati Lavdar:** Asfaltim i rrugës Voskop-Lavdar, zgjidhje e ujitjes së parcelave.
- **Fshati Gjonomadh:** Problem rrjeti i kanalizimeve
- **Fshati Krushovë:** Ndërhyrje në sezonin e reshjeve, sistemim i rrugës tek kisha e Shën Mëhillit
- **Fshati Marjan:** Riparim i rrugës që lidh katër fshatra, sistemimi i urës
- **Fshati Mazrekë:** Riparim i rrugës së fshatit

Në fshatin Voskopojë (Xxxxxx) Na vjen mirë që u investua për ujësjellësin e fshatit i cili është ende në proces pune, do të jetë një ndihmesë e madhe për ne. Kemi nevojë për një ndërhyrje sistemuese në rrugët me kalldrëm dhe sistemimin e rrugëve në parcela për t'u evidentuar nga pronarët e rinj.

Në fshatin Shipskë (Xxxxxx) Në fshatin tonë kemi probleme të herë pas herëshme me rrugën e fshatit, e pranojmë që është investuar për riparimin e saj, por ka nevojë për mirëmbajtje pasi është dëmtuar sërish. Tek kisha e fshatit, kemi problem me daljen e ujrave të zeza në sipërfaqe, mendoj se duhet gjetur një zgjidhje.

Në fshatin Lavdar (Xxxxxx) Kërkojmë nga bashkia, ndërtimin e një kanali tek rezervuari në mënyrë që të kemi mundësi të ujitim parcelat. Mungesa e qendrës shëndetsore mbetet problem për ne. E kemi kërkuar disa herë pasi është vërtet e nevojshme për fshatin tonë.

Në fshatin Gjonmadh:(Xxxxxx) Jemi falenderues për ujësjellësin e ndërtuar në fshatin tonë që ka zgjidhur një problem mjaft të madh i cili na shqetësonte prej vitesh. Tani kemi probleme me kanalizimet e ujrave të zeza.

Në fshatin Krushovë (Xxxxxx) Ne si fshat kërkojmë të jetë më tepër në vëmendje mirëmbajtja e rrugës gjatë dimrit, pasi bllokohet nga bora dhe është e pamundur të kalohet. Po ashtu edhe rruga tek kisha e Shën Mëhillit është e pashtuar.

Në fshatin Marjan:(Xxxxxx) Ajo që kërkojmë si fshat është një ndërhyrje tek rruga që lidh katër fshatra në njësinë Lekas. Sistemimi i urës së fshatit gjithashtu është një kërkesë e jona pasi në kohën e reshjeve lumi del nga shtrati.

Në fshatin Mazrekë:(Xxxxxx) Për rrugën u mbajt premtimi prandaj ju falenderojmë për investimin e bërë, por rruga me kalimin e kohës ka pësuar dëmtime, është shembur në disa pjesë dhe ka nevojë për mirëmbajtje.

VITHKUQ

- **Fshati Vithkuq:** probleme me lumin në lagjen Saraç, sistemim i rrugëve me kalldrëm, sistemim i kanalizimeve
- **Fshati Lubonjë:** Përfundim i rrugës që lidh me Ersekën, pastrim i kanaleve kulluese
- **Fshati Leshnje:** Sistemim i rrjetit të ujrave të zeza, betonizimi i kanalit vaditës
- **Fshati Panarit:** Pastrim i kanaleve kulluese, ndërtimi i disa urave
- **Fshati Shtyllë:** Ndërhyrje në rrjetin e ujit të pijshëm, riparim i kabinës elektrike

Në fshatin Vithkuq (Xxxxx) Vazhdojmë të kemi probleme me lumin në lagjen Saraç i cili mbetet shqetësim për banorët. Po ashtu sistemimi i rrugëve me kalldrëm është një tjetër kërkesë e jona. Megjithëse kemi dy rezervuarë, asnjëri prej tyre nuk funksionon për vaditjen e tokave. Do të ishte mirë të riparohej sistemi vaditës dhe ai i kanalizimeve të ujrave që një pjesë është jashtë funksioni.

Në fshatin Lubonjë (Xxxxx) Në fshatin tonë ka mbetur edhe 2 km rrugë e paasfaltuar dhe shpresojmë të përfundojë sa më shpejt. Pjesa më e madhe e kanaleve kullues të fshatit kanë nevojë për pastrim. Është e nevojshme vendosja e një prite në lumë pasi gjatë dimrit ka shumë prurje.

Në fshatin Leshnje (Xxxxx) Ju falenderojmë për investimin tek ujësjellësi pasi na keni zgjidhur një problem i cili ishte shumë i madh për ne. Problem për fshatin tonë mbetet sistemimi i ujrave të zeza si dhe kanali vaditës prej 300 m, i cili duhet izoluar me beton sepse uji shkon në banesa.

Në fshatin Panarit: (Xxxxx) Në rrugën që të çon në fshat duhet ndërtuar një mur tek përroi pasi shkakton dëmtimin e asfaltit. Kërkojmë ndërtimin e disa urave përgjatë lumit për të na lehtësuar lëvizjen. Problemi kryesor për Panaritin është bllokimi i rrugës gjatë dimrit si pasojë e borës, prandaj kërkojmë më shumë vëmendje për mirëmbajtje dimërore.

Në fshatin Shtyllë: (Xxxxx) Puseta në fshat që shërben për ujin e pijshëm nuk i plotëson nevojat që kanë banorët e gjithë fshatit. Jemi të mendimit se duhet ndërtuar një kabinë e re pasi kabina ekzistuese është e amortizuar.